



KOMUNA E BOGOVINËS



**STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK
LOKAL E KOMUNËS SË BOGOVINËS PËR
PERIUDHËN 2023-2027**

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Qëllimi i dokumentit	4
3. Koncepti dhe metodologjia.....	4
4. Harmonizimi i Strategjisë me dokumentet strategjike, programet, planet dhe legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar	6
I.....	9
1. Vështrimi i shkurtër i gjendjes në komunën e Bogovinës.....	9
1.1. Profili i komunës	9
1.1.1. Lokacioni i komunës dhe karakteristikat gjeografike.....	9
1.1.2. Karakteristikat demografike.....	10
1.1.3. Kushtet e jetesës.....	13
1.2. Organizimi i vetëqeverisjes lokale Bogovinë.....	22
1.2.1. Komuna e Bogovinës.....	22
1.2.2. Organizimi i administratës	23
1.2.3. Palët e interesuara - ndikimi, pritshmëritë dhe resurset.....	25
1.3. Trendet e zhvillimit të komunës së Bogovinës 2019-2021	26
1.3.1. Lëvizja e popullsisë.....	26
1.3.2. Trendet ekonomike.....	28
1.3.3. Punët ndërtimore, objekte dhe banesa	30
1.4. Pjesëmarrja e buxhetit komunal në financimin e zhvillimit.....	31
1.4.1. Të ardhurat dhe shpenzimet.....	31
1.4.2. Të ardhurat dhe shpenzimet kapitale	32
1.5. Qëndrimet e palëve të interesuara në drejtimin e zhvillimit lokal	33
1.5.1. Anketa e aktorëve relevant në zhvillimin lokal	33
II	35
2. Qasja strategjike.....	35
2.1. Analiza e mjedisit	35
2.1.1. Analiza PESTLE.....	35
2.1.2. SWOT Analiza e njësive të vetëqeverisjes lokale	37
2.2. Qëllimet strategjike të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Bogovinës	39

2.2 .1. Vizioni i komunës	39
2.2.2. Misioni i komunës	39
2.2.3. Qëllimet strategjike.....	39
2.2.4. Ndjekja e realizimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal	39
III	41
1. Plani akcional	41

Lista e tabelave

Tabela 1. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Bogovinës për periudhën 2019-2021.....	12
Tabela 2. Banesat dhe shfrytëzueshmëria e tyre.....	13
Tabela 3. Numri i nxënësve në shkollat fillore sipas gjinisë.....	16
Tabela 4.Toka bujqësore në komunën e Bogovinës	19
Tabela 5. Persona të papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim-Tetovë që në mënyrë aktive kërkojnë punë në vitin 2020	20
Tabela 6. Persona të papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim-Tetovë që në mënyrë aktive kërkojnë punë për vitin 2021.....	20
Tabela 7. Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve komunale në ndërrmarje (grumbullimi i mbeturinave)..	21
Tabela 8. Lindshmëria në periudhën 2019-2021	27
Tabela 9. Vdekshmëria në periudhën 2019-2021.....	27
Tabela 10. Numri i nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2019-2021.....	28
Tabela 11. Numri i mësimdhënësve në vitin shkollor 2019-2021.....	28
Tabela 12. Numri i subjekteve aktive në bazë të sektorëve të veprimtarisë.....	28
Tabela 13. Ndërrmarjet ekonomike sipas madhësisë.....	30
Tabela 14. Punët e kryera ndërtimore, sipërfaqja dhe vlera e tyre 2019 -2021	30
Tabela 15. Punët e kryera ndërtimore në bazë të llojeve të objektëve ndërtimore, në përputhshmëri me Nomenklaturën e punëve ndërtimore, në mijë (000) denarë në Komunën e Bogovinës 2019-2021	31
Tabela 16. Investimet kapitale në bazë të programeve zhvillimore 2019-2021.....	32
Tabela 17. Të ardhurat buxhetore në komunën e Bogovinës 2019-2021	50
Tabela 18. Shpenzimet e buxhetit të komunës së Bogovinës 2019-2021	51
Tabela 19. Shpenzimet në bazë të programeve të buxhetit komunal 2019 - 2021.....	52

1. Hyrje

Planifikimi strategjik është një metodë demokratike për krijimin e vizionit dhe mënyrave për të arritur të ardhmen e dëshiruar të komunës dhe shërben për drejtimin e aktiviteteve dhe projekteve në drejtim të zhvillimit ekonomik të paraqitura në formë të dokumentit: Strategjia për zhvillimin ekonomik lokal, të përgatitur në përputhje me Rregulloren për Metodologjinë për përgatitjen e planeve dhe dokumenteve për zhvillim rajonal, të miratuara nga Ministria e vetëqeverisjes lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 102/09).

Krahas zhvillimit ekonomik, për banorët e komunës së Bogovinës, veçanërisht është e rëndësishme edhe zhvillimi i zonave të tjera nën juridiksionin e komunës që e bëjnë komunën e Bogovinës një vend funksional, efikas, efektiv dhe modern për jetesë. Zhvillimi ekonomik lokal është një proces me të cilin autoritetet lokale menaxhojnë në mënyrë efektive dhe efikase burimet në dispozicion dhe krijojnë kushte për të stimuluar aktivitetin ekonomik dhe për të hapur vende të reja pune.

Planifikimi strategjik është një proces i të kuptuarit të situatave në të cilat ndodhet komuna, një analizë që duhet të identifikojë nevojat në të gjitha sferat e jetës dhe në bazë të këtyre identifikimeve të krijojë zgjidhje që do të ishin të mundshme për t'u zbatuar në përpjekje për zgjidhjen e nevojave komunale dhe ato duhet të bazohen në nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në mënyrë që zgjidhjet të jenë realisht të arritshme, reciproke të lidhura dhe të integruara për të ndikuar në situatën ekzistuese, kërkohet ekzistenca e një vizioni të përbashkët se ku qytetarët dhe institucionet d.m.th. të gjithë aktorët duan që të shohin komunën në të ardhmen dhe mënyrat se si të arrihet atje.

Strategjia përcakton qëllimet, prioritetet dhe masat zhvillimore që bazohen në objektivat dhe parimet themelore të përfshirjes së të gjithë potencialeve që ka në dispozicion. Ato duhet të vihen në funksion për të reduktuar ato më të theksuarat dallimet ekonomike dhe sociale në komunë.

Gjithashtu, në përpilimin e strategjisë janë bërë konsultime me institucionet përkatëse, qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve në të gjitha fazat e përgatitjes, ku merren parasysh: ekonomia, arsimi, infrastruktura dhe mjedisi, kultura, mbrojtja shëndetësore dhe sociale e fëmijëve.

Në procesin e hartimit të Strategjisë, komuna e Bogovinës është fokusuar në gjithë territorin e vet dhe të gjitha vendbanimet e saj, ku bazohet në strategjinë e ZHEL-it për të forcuar kapacitetin e ekonomisë lokale, për të përmirësuar klimën e investimeve, produktivitetin dhe konkurrencën e bizneseve vendase, sipërmarrësve dhe punëtorëve. Zhvillimi ekonomik lokal

(ZHEL) i ofron një mundësi vetëqeverisjes lokale, sektorit privat dhe sektorit jofitimprurës, si dhe bashkësive lokale, për të punuar së bashku në përmirësimin e ekonomisë lokale.

Zbatimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me pozitën ekonomiko - sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të komunës së Bogovinës.

2. Qëllimi i dokumentit

Sfida për të qenë të suksesshëm në një mjedis dinamik e nxit gjithnjë e më shumë nevojën për planifikimin strategjik të organizatave dhe institucioneve. Dokumenti Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal i Komunës së Bogovinës 2023-2027 synon të mbështes vendimmarrësit në komunë në punën e tyre për menaxhimin e suksesshëm të zhvillimit të komunës sipas prioriteteve dhe t'i drejtojë resurset komunale për përmirësimin e nivelit të aktiviteteve ekonomike në komunë, punësimet, standardin dhe mirëqenien e qytetarëve si dhe të shërbejë si dokument bazë ku janë të cituara prioritetet, qëllimet strategjike të komunës dhe të shërbejë si referencë për të aplikuar në thirrjet e shpallura nga institucionet shtetërore dhe ndërkombëtare.

Prandaj, përgatitja e dokumentit ka për qëllim zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, ndërmarrjen e masave relevante për efikasitet energjetik, prodhim bujqësor të avancuar dhe standard/ cilësi të lartë të jetës në të gjithë zonat e komunës, mjedis i mbrojtur dhe i pastër, me infrastrukturë të planifikuar dhe cilësore sipas nevojave të qytetarëve si dhe krijimin e të gjithë parakushteve për zhvillimin e turizmit rural.

Qëllimet do të mund të arrihen me mobilizimin e administratës komunale, mbështetjen e bizneseve lokale, me involvimin e OJQ-ve dhe qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në prioritetet zhvillimore.

3. Koncepti dhe metodologjia

Metodologjia përcaktoi fazat dhe procedurat në procesin e zhvillimit të Strategjisë. Gjithashtu, parashikon dinamikën e aktiviteteve përmes të cilave sigurohet arritja e qëllimeve strategjike.

Procesi i përpilimit të Strategjisë përfshin konsultant të jashtëm dhe grupin punues të administratës komunale duke kaluar në këto faza:

- Përcaktimi i grupeve të interesit (aktorëve) që kanë marrë pjesë në procesin e përgatitjes së Strategjisë në mënyrë indirekte, siç janë anëtarë të sektorit të biznesit, organizatat joqeveritare, institucionet shtetërore etj. Për realizimin e këtij aktiviteti janë përcaktuar katër grupe të synuara nga fusha të ndryshme: punëdhënësit, organizatat joqeveritare, këshilltarët në komunën e Bogovinës dhe administrata komunale.

- Analiza e dokumenteve strategjike dhe planifikuese të disponueshme në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar dhe hulumtimi i grupeve të interesit me qëllim identifikimin e sfidave, nevojave, barrierave dhe shtytësve për zhvillimin ekonomik lokal, qëllimeve dhe masave strategjike. Një analizë e barrierave dhe shtytësve për zhvillimin ekonomik lokal është bërë përmes një pyetësores për punonjësit dhe këshilltarët në komunë, si dhe përmes intervistave sistematike me punëdhënësit dhe organizatat joqeveritare.

- Përgatitja e një pasqyre të situatës aktuale dhe mjedisit në komunë. Hulumtimi përfshin informacion mbi vendndodhjen dhe demografinë e komunës; (pa) punësimi; infrastrukturën rrugore, punët ndërtimore të përfunduara, arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin, mjedisin jetësor, ekonominë etj. Informacioni i mbledhur thekson nevojën për projekte dhe programe specifike që do ta zgjerojnë dhe ta zhvillojnë ekonominë lokale. Këtyre të dhënave i'u shtuan edhe të dhënat e administratës komunale, përbërja e këshillit të komunës dhe roli i tyre në procesin e zhvillimit ekonomik lokal.

- Për të identifikuar nxitësit kryesorë të ndryshimit në mjedisin strategjik dhe për të mbështetur vendimmarrjen strategjike u përgatit edhe analiza PESTLE që paraqet një mjet analitik që përdoret për përfshirjen e faktorëve politikë, ekonomikë, social, teknologjikë, ekologjikë dhe juridikë.

- Për të identifikuar informacionin kryesor për ekonominë lokale, u përgatit edhe analizë SWOT për fushat strategjike. Për të mbledhur informacion të detajuar rreth ekonomisë lokale, janë përdorur metoda dhe qasje të ndryshme për të kuptuar ekonominë lokale, të tilla si takime me palët e interesuara të biznesit dhe grupet e komunitetit, intervista dhe anketa të thjeshta.

Struktura e strategjisë është si vijon:

Në fillim është hyrja, qëllimi i përpilimit të strategjisë, koncepti dhe metodologjia, harmonizimi me dokumente relevante nacionale dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i parë

Pasqyrë e shkurtër e gjendjes në komunë i paraqitur nga profili i komunës, organizimi i komunës, trendet në zhvillimin dhe pjesëmarrjen e buxhetit komunal në financimin e zhvillimit lokal.

Kapitulli i dytë

Përfshin misionin dhe vizionin e komunës së Bogovinës, analizën PESTLE, SWOT analizën, prioritetet dhe qëllimet strategjike, përputhshmërinë e tyre me dokumentet rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare.

Kapitulli i tretë

Plani akcional ku përfshihen shqyrtimi i projekteve (iniciativave) të grupuara për realizimin e qëllimeve, prioritetet, aktivitetet, indikatorët për zbatimin e suksesshëm të projekteve, korniza kohore institucionet përgjegjëse dhe vlera.

4. Harmonizimi i Strategjisë me dokumentet strategjike, programet, planet dhe legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar

Në nenin 22 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare" e RM-së, nr.05/22) janë përcaktuar kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale. Në bazë të paragrafit (1) pika 3 të ligjit në fjalë një ndër kompetencat kyçe të komunave është edhe zhvillimi ekonomik lokal-planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal; përcaktimi i përparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politikën ekonomike; përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimi i partneritetit¹. Të njejtat kompetenca në fushën e zhvillimit ekonomik lokal janë të përcaktuara edhe në nenin 24 paragrafi (3) të Statutit të komunës së Bogovinës².

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal është në harmonizim me kompetencat dhe fushën e veprimit të përcaktuar në legjislacionin nacional edhe atë: legjislacionin e fushës së mbrojtjes sociale; legjislacionin e fushës së mjedisit jetësor; legjislacionin për eficientë e energjisë, legjislacionin për rini dhe sport, Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal etj. Duke marrë parasysh trendet e zhvillimit të komunave të vendeve të rajonit dhe më gjërë zhvillimi në bazë të nenit 186 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit jetësor organet e pushtetit qendror dhe komunat janë të detyruar të kujdesen për zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut të përcaktuara në Strategjinë nacionale për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Maqedonisë

¹ Ministria e vetëqeverisjes lokale

² Komuna e Bogovinës

Pjesa I / II (2009 - 2030)³. Gjithashtu, dokumentet tjera relevante në të cilët bazohet Strategjia janë:

- Strategjia për barazi gjinore 2022-2027⁴;
- Plani nacional për energjinë dhe klimën në Republikën e Maqedonisë së Veriut⁵;
- Strategjia nacionale për bujqësi dhe zhvillim rural për periudhën 2021-2023⁶;
- Strategjia nacionale për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (2018 – 2023)⁷;
- Strategjia për zhvillim rajonal e Republikës së Maqedonisë së Veriut⁸ 2021-2031;
- Programi për zhvillim të rajonit planor të Pollogut 2021-2026⁹; dhe
- Programi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021-2026¹⁰.

Objektivat e qëndrueshmërisë janë vlerat thelbësore që duhet të paraprijnë në çdo veprim lokal dhe ndërkombëtar që marrin komunitat. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një thirrje globale për veprim, për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur mjedisin dhe klimën në Tokë dhe për të siguruar që njerëzit, pavarësisht vendndodhjes të kenë paqe dhe mirëqenie. Strategjia është në harmonizim me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara-SDG:

1. Pa varfëri;
2. Zero uri;
3. Shëndet i mirë dhe mirëqenie;
4. Arsimit cilësor;
5. Barazi gjinore;
6. Uji i pastër dhe kanalizime;
7. Energji e ripërtijshme dhe e pastër;
8. Punë dinjitoze dhe ekonomike;
9. Industri, inovacion dhe infrastrukturë;
10. Zvogëlim i pabarazisë sociale;

³Strategjia nacionale për zhvillim të qëndrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut pjesa I / II (2009 - 2030)

⁴Ministria e Punëve të Brendshme dhe Politikës Sociale

⁵Plani nacional i energjisë dhe klimës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁶IPARD

⁷Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁸Strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2031

⁹Programi për zhvillimin planit regjional të Pollogut 2021 - 2026

¹⁰Programi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim

11. Qytete dhe komunitete të qëndrueshme;
12. Konsum dhe prodhim i përgjegjshëm;
13. Veprim për klimën;
14. Jeta nën ujë;
15. Jeta në tokë;
16. Paqe dhe drejtësi, institucione të forta;
17. Partneritet për objektivat.

Poashtu, kjo strategji është në përputhshmëri me 6 Prioritetet e Komisionit Europian për periudhën 2019-2024:

- Një marrëveshje e gjelbër evropiane;
- Një Evropë e përshtatshme për epokën digjitale;
- Një ekonomi që funksionon për njerëzit;
- Një Evropë më e fortë në botë;
- Promovimi i mënyrës sonë evropiane të jetesës;
- Një shtysë e re për demokracinë evropiane.

Komunat përqipen të përmirësojnë konkurrencën e tyre në skenën botërore. Ato komuna që kanë sukses në tërheqjen e bizneseve, investimeve, burimeve njerëzore të kualifikuara dhe të talentuara do të kenë sukses në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit të avancuar të teknologjive digjitale për të optimizuar burimet e komunës, reduktuar harxhimet, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ofrimin e shërbime më të mira për qytetarët prandaj kjo strategji duhet të jetë në përputhje me Agjendën digjitale për Evropën¹¹.


¹¹ Agjenda digjitale për Evropën

I.

1. Vështrimi i shkurtër i gjendjes në komunën e Bogovinës

1.1. Profili i komunës

1.1.1. Lokacioni i komunës dhe karakteristikat gjeografike



Komuna e Bogovinës gjendet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në anën e majtë të lumit Vardar, nën shpatet e Malit Sharr, në luginën e Pollogut, ku edhe kalon rruga kryesore - autostrada Shkup - Tetovë-Gostivar. Paralelisht me autostradën gjendet edhe rruga rajonale e cila e lidh komunën me vendbanimet tjera deri në komunën e Tetovës dhe komunën e Gostivarit.

Pas shpalljes së Malit Sharr park kombëtar pozita gjeografike e komunës bëhet një ndër anët më të forta të komunës, pasi që do të krijohen kushte për të krijuar një vend me më shumë mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe malor.

Territori i komunës së Bogovinës ka një hapësirë prej 143.44 km² dhe gjendet në lartësi mbidetare prej 460 deri më 1.150 m. Në bazë të Ligjit për ndarjen e re territoriale komuna e Kamjanit iu bashkangjiti komunës së Bogovinës dhe u shndërrua në një komunë më të madhe se sa ishte paraprakisht. Aktualisht, komuna e Bogovinës kufizohet me komunën e Tetovës, komunën e Vrapçishtit, komunën e Bërvenicës dhe në një pjesë të vogël të territorit edhe me Republikën e Kosovës.

Komuna e Bogovinës është kryesisht komunë rurale. Numri i përgjithshëm i vendbanimeve në komunë është 16 dhe ato janë: Bogovinë, Pirok, Rakovec, Sellcë, Zherovjanë, Kamjan, Jellovjan, Pallçisht i Epërm dhe i Poshtëm, Sellarcë e Epërme, Siniçan, Urviç, Novak, Çiflik, Kallnik dhe Novo Sellë. Nga këto vendbanime 8 gjenden në pjesën malore të komunës, gjejmësisht në Malin Sharr dhe të tjerat në pjesën e poshtme.

1.1.2. Karakteristikat demografike

Aspekti demografik i analizës i përfshin të dhënat në vijim:

- numri i përgjithshëm i popullatës (për vitin 2019, 2020 dhe 2021), kategorizimi i popullatës (sipas moshës, arsimimit, gjinisë);
- popullsia sipas vendbanimeve;
- shkalla e lindjes dhe vdekjes (lidhje në mes numrit vjetor të lindjeve dhe vdekjeve)
- migrimet në dhe nga komuna.

Në bazë të regjistrimit të fundit të vitit 2021 të popullsisë në komunën e Bogovinës jetojnë 22 906 banorë në një sipërfaqe prej 143.44 km², me një dendësi të popullsisë prej 160 banorë/km², që është në nivelin e dendësisë së popullsisë në rajonin e Pollogut. Në komunën e Bogovinës jeton 1,24 % e popullsisë së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.¹²

Struktura kombëtare e popullsisë është si vijon: shqiptarë 20.475 (89,38%); maqedonas 16 (0,06%); 806 (3,5%); vllah 1(0,004%); serb 2 (0,008%), boshnjakë 6 (0,026%); të tjerë 35 (0,15%) dhe 1567 (6,84%) persona për të cilët të dhëna janë marrë nga burimet administrative.


Në vendbanimet që shtrihen në pjesë të rrafshta të komunës numri i banorëve është më i madh, ndërsa në vendbanimet malore për shkak të pozitës gjeografike numri i banorëve është më i ulët. Në vendbanimin Bogovinë jetojnë 5239 banorë, Pirok 3963 banorë, Kamjan jetojnë 3654 banorë, Pallçisht i Poshtëm 2563 banorë, Sedllarcë e epërme 1521 banorë, Siniçan 1205 banorë, Pallçisht i Epërm 1127, Zherovjan 891, Urviç 746, Rakovec 577, Jellovjan 283, Novo Sellë 877, Novak 174 dhe Sellcë e Keqe 86 banorë.

Sipas të dhënave statistikore struktura sipas moshës e popullsisë është e favorshme edhe atë nga 0 deri në 14 vjeç janë 19,29 %, nga 15 deri në 64 vjet janë 69,3 % të popullsisë dhe të moshës mbi 65 vjet janë 11,39 %. Të dhëna më të detajuara janë të paraqitura në grafikonin në vijim.¹³

¹² Regjistrimi i popullsisë 2021

¹³ Regjistrimi I popullsisë 2021


Grafikoni 1. Popullsia rezidente sipas grupmohave



Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Gjithmonë duke iu referuar të dhënave statistikore të regjistrimit të popullsisë të vitit 2021 sipas strukturës gjinore 50,04% e popullsisë janë femra, ndërsa 49,95% meshkuj dhe është përafërsisht e njëjtë me strukturën gjinore në nivel të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Grafikoni 2. Struktura gjinore e popullsisë së komunës së Bogovinës dhe RMV-së



Burimi: Enti shtetëror i statistikës


Në vijim është paraqitur numri i popullsisë në nivel komunal nga viti 2019 deri në vitin 2021 dhe përbërja gjinore.

Tabela 1. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Bogovinës për periudhën 2019-2021

	2019	2020	2021
Gjithësej	31 094	31 070	22 906
Femra	15 897	15 917	11 443
Meshkuj	15 197	15 159	11 463

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Grafikoni 3. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Bogovinës për periudhën 2019-2021



Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë dhe grafikon vërehet se numri i përgjithshëm i banorëve rezident ka pësuar rënie si pasojë e mirgimit të brendshëm dhe të jashtëm. Sa i përket migrimëve të brendshme të popullsisë në komunën e Bogovinës, të dhënat statistikore të vitit 2017 tregojnë një ekuilibër relativ të lëvizjeve në lidhje me emigrantët dhe personat e zhvendosur në komunat tjera nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Numri i përgjithshëm i personave të vendosur është 86, ku 60 janë vendosur nga komunat tjera në komunën e Bogovinës dhe 26 kanë lëvizur brenda komunës nga vendbanime të ndryshme. Sa i përket emigrimit nga të dhënat e paraqitura në Publikimin e entit statistikor del se vetëm një person ka emigruar në periudhën 2013-2017. Këto shifra nuk mund të merren si bazë pasi që numri është shumë më i lartë.

Liberalizimi i vizave, varfëria, papunësia dhe një numër i madh i faktorëve tjerë social dhe ekonomik nga njëra anë dhe lehtësimi dhe gatishmëria nga ana e vendeve të Bashkimit European për të mirëpritur fuqinë punëtore nga vendet e Ballkanit mundësojnë rritjen e trendit të emigrimit të popullsisë së re që është e aftë për punë. Në territorin e komunës së Bogovinës


është në trend emigrimi jashtë vendit dhe për fat të keq është në rritje nëse nuk merren masa konkrete për ndalimin e kësaj dukurie.

1.1.3. Kushtet e jetesës

1.1.3.1. Amvisëritë

Në komunën e Bogovinës numri i përgjithshëm i amvisërive është 6.457 dhe numri i përgjithshëm i banesave është 7.759. Ndërsa, këto zënë një hapësirë të shfrytëzuar prej 1.387.404 m². Nga numri i përgjithshëm i banesave 5.354 janë banesa të banuara ku hapësira e shfrytëzuar është me sipërfaqe prej 941.460m², ndërsa 2.405 prej tyre janë banesa të pabanuara dhe hapësira e shfrytëzuar në komunë është 445.944m². Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën 2.

Grafikoni 3. Numri i përgjithshëm i amvisërive



Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Tabela 2. Banesat dhe shfrytëzueshmëria e tyre

Komuna e Bogovinës	Numri i përgjithshëm i banesave	Hapësirë e shfrytëzuar në m ²	Banesa të banuara	Hapësirë e shfrytëzuar në m ²	Banesa të pabanuara	Hapësirë e shfrytëzuar në m ²
	7.759	1.387.404	5.354	941.460	2.405	445.944

1.1.3.2. Infrastruktura e komunës

Infrastruktura rrugore

Në zonën e njësive të vetëqeverisjes lokale të cilat gravitojnë në zonën që e mbulon rajonin e Bogovinës, ekziston një rrugë mjaft e zhvilluar dhe një pjesë e vogël e rrjetit hekurudhor, e cila kalon në një pjesë të vogël në NJVL-Brvenicë.

Komuna është gjithashtu afër Korridorit X, gjë që i jep asaj një lidhje të rëndësishme infrastrukturore me një numër më të madh qendrash ekonomike dhe kulturore ndërkombëtare në Ballkanin Perëndimor. Është me rëndësi të theksohet se komuna e Bogovinës kufizohet me Republikën e Kosovës, por nuk ka pikë kalimi kufitar në territorin e Komunës apo në ndonjë vendbanim të afërt të saj.

Me rëndësi të madhe janë rrugët: Bogovinë-Tetovë, Bogovinë-Gostivar dhe Bogovinë-Brvenicë që lidhen për rrjetin e rrugëve të degëzuara me rrugët rajonale nga radha e IV, të cilët e lidhin të gjithë komunën me komunën e Tetovës, komunën e Brvenicës dhe komunën e Gostivarit dhe poashtu lidhen me autostradën M-4 dhe ofrojnë qasje të drejtpërdrejtë dhe të lehtë për një numër të madh të qytetarëve dhe subjekteve në arterien kryesore të transportit. Këto rrugë janë të lidhura edhe me rrugë të tjera të rangut të tretë dhe të katërt, të cilat kontribuojnë dukshëm në lidhjen transportuese të vendbanimeve në komunë.

Me rrjetin e rrugëve lokale (të rangut të tretë dhe të katërt) ndërlidhen të gjitha vendbanimet e komunës së Bogovinës, por edhe me qytetin e Tetovës dhe qendrat tjera urbane në rajonin e Pollogut. Ky rrjet mundëson lidhjen rrugore për çdo banor të territorit të komunës së Bogovinës në të gjitha drejtimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë saj. Duhet theksuar se cilësia e këtyre rrugëve është e ndryshme. Ky rrjet përbëhet nga rrugë të reja lokale, por ka edhe nga ato që kanë nevojë për rehabilitim të menjëhershëm, në radhë të parë për rrjedhën e sigurt të trafikut. Mirëmbajtja e këtyre rrugëve është në nivel shumë të ulët dhe duhet të përmirësohet si parakusht për të mundësuar zhvillim të përsheptuar rural - si synim strategjik afatgjatë i komunës, por edhe për të parandaluar migrimin e popullsisë rurale në komunën e Bogovinës. Në zonën e njësive të vetëqeverisjes lokale të cilat gravitojnë në zonën që e mbulon rajonin e Bogovinës, ekziston një rrugë mjaft e zhvilluar dhe një pjesë e vogël e rrjetit hekurudhor, e cila kalon në një pjesë të vogël në NJVL-Brvenicë.

Komunikacioni ajror zhvillohet përmes aeroportit Internacional të Shkupit, i cili është në një distancë prej rreth 90 km nga komuna e Bogovinës dhe aeroportit Shën Apostol Pavle në Ohër, i cili ndodhet në një distancë prej rreth 110 km dhe qasja në aeroporte është e mirë dhe e shpejtë dhe bëhet përgjatë autostradës së Korridorit VIII.

Kanalizimi

Në komunën e Bogovinës infrastruktura e kanalizimit nuk ka qenë në nivelin e duhur, por viteve të fundit kjo problematikë është duke u përmirësuar. Një nga sfidat kryesore që ka ngadalësuar zhvillimin e infrastrukturës së kanalizimit ka qenë shpërndarja territoriale e gjërë, në sipërfaqen e territorit administrativ të saj si dhe mungesa e mjeteve financiare për të mbuluar tërë vendbanimet.

Në disa vendbanime gjendja vazhdon të jetë kritike. Nuk ka rrjet kanalizimi, mirëpo Bashkimi Evropian zbatoi master plane për ujërat e zeza në Manastir, Strumicë dhe Tetovë, në kuadër të projektit "Përgatitja e studimeve, projekt dokumentacionin dhe dosjet e tenderit për projektet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të zeza në komunat Strumicë, Manastir dhe Tetovë". Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Tetovë do të shërbejë për 95.152 banorë në komunat e Tetovës, Bërvenicës, Bogovinës dhe Zhelinës me një normë lidhjeje prej gati 100% të popullsisë në zonë deri në vitin 2039¹⁴. Sipas të dhënave të autoriteteve komunale rrjeti i kanalizimit pritet të realizohet në faza dhe brenda katër viteve të ardhshme i gjithë territori i Komunës së Bogovinës të mbulohet me rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza. Komuna është në ndërtim të rrjeteve të kanalizimeve në vendbanimet Bogovinë dhe Kamjan dhe projekti është në fazën përfundimtare, ku do të përfshihen përafësisht të gjithë amvisëritë, ndërsa për vendbanimet tjera janë të përgatitura dokumentacion teknik. Komuna është në përgatitje të studimit të fizibilitetit për trajtimin e ujërave të zeza, ku do të parashihet ndërtim i kolektorit kryesor dhe stacionit të filtrimit.

Uji për pije

Territori i Komunës së Bogovinës është i pasur me rrjedha ujore të përhershme dhe të rastësishme, duke formuar një rrjet lumenjsh piktoreskë dhe përrenjsh të pasur me ujë gjatë gjithë vitit. Shumica e rrjedhave ujore kanë ujë të pa ndotur. Gjatë shirave dhe shkrirjes së borës zbresin një numër i madh përrenjsh nëpër shpatet e maleve përreth. Shumësia e lumenjve dhe përrenjve i japin komunës një veçori të veçantë dhe vlera përse i përket turizmit rural dhe atij alternativ. Furnizimi me ujë të pijshëm në komunën e Bogovinës realizohet nga burimet malore lumenjtë dhe përrenjtë. Në disa vendbanime ku menaxhon ndërmarrja publike komunale NPK "Sharri" me ujin e pijshëm në vendbanimet (Pirok, Kamjan, Sellarcë, Siniçan) ka sasi uji të mjaftueshme, përveç në muajin gusht dhe shtator ku ka mungesë të ujit. Duhet theksuar se problemi i furnizimit me ujë është ende i pranishëm në disa vendbanime pavarësisht përpjekjeve për ta përmirësuar atë.

¹⁴Programi për zhvillim të rajonit planor të Pollogut 2021-2026

Në disa vendbanime si Zherovjan dhe Pallçisht ka nevojë të shtohet sasia e ujit për pije. NPK "Sharri" ofron shërbime komunale dhe ujë të pijshëm për 5.758 amvisëri dhe 500 afaristë.

Energjia

Gjendja e infrastrukturës energjetike në territorin e komunës është relativisht e mirë dhe stabile. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga ESM-EVN SHA. Komuna ka 25 nënstacione, lloji i tipit të kabllove është 2x16, tensioni i mesëm¹⁵.

1.1.3.3. Arsimi

Në komunën e Bogovinës është i pranishëm vetëm arsimi fillor. Ekzistojnë gjashtë shkolla fillore qendrore dhe tetë shkolla fillore territoriale edhe atë: "Abdyl Frashëri" – Bogovinë, "Sami Frashëri" – Pirok, "Liria" – Zherovjan, "Sabedin Bajrami" – Kamjan, "Dervish Cara" – Pallçisht i Poshtëm, "11 Tetori" – Urviç, "Abdyl Frashëri" – Rakovec (territoriale), "Abdyl Frashëri" – Sellcë e Keq (territoriale), "Sabedin Bajrami" – Sellarcë (territoriale), "Sabedin Bajrami" – Siniçan (territoriale), "Dervish Cara" – Kallnik (territoriale), "Dervish Cara" – Novakë (territoriale), "11 Tetori" – Jellovjan (territoriale), "11 Tetori" – Novosellë (territoriale). Në territorin e komunës më saktësisht në Kamjan gjendet shkolla fillore dhe e mesme private "Yahja Kemal College".

Në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i nxënësve në shkollat fillore për vitin 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022¹⁶.

Tabela 3. Numri i nxënësve në shkollat fillore sipas gjinisë

Viti	2019/2020	2020/2021	2021/2022
Nxënës	1442	1398	1388
Nxënëse	1320	1280	1269
Gjithësej	2762	2678	2657

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërehet se numri i nxënësve nga viti në vit është më i ulët, kjo rrjedh si pasojë e migrimit të popullsisë në shtetet e Evropës në kërkim të një jetë më të mirë.

¹⁵Të dhëna nga autoritetet komunale

Sa i përket edukimit parashkollor në territorin e komunës operon çerdhja “Jeta” në fshatin Kamjan e hapur më 2022 dhe një qendër ditore/ çerdhe në fshatin Bogovinë e cila është në kuadër të çerdhes “Rinia” Tetovë.

1.1.3.4. Shëndetësia

Në komunën e Bogovinës ekziston një rrjet i zhvilluar shëndetësor, në të cilin u ofrohet kujdes shëndetësor cilësor dhe i larmishëm nëpërmjet pesë shtëpive të shëndetit në disa vendbanime si Bogovinë, Pirok, Kamjan, Pallçisht dhe Zherovjan. Në gjithë komunën ekzistojnë 7 ordianca stomatologjike dhe 13 barnatore¹⁷. Në komunën e Bogovinës dhe në tërë rajonin e Pollogut nuk ka institucion për përkujdesje të pleqve, duke marrë parasysh trendin e migracionit të rinjëve hapja e një institucioni që ofron shërbime për të moshuarit do të jetë më se e nevojshme për rajonin e Pollogut.

1.1.3.5. Kultura

Aktivitetet kulturore organizohen zakonisht gjatë festave të nëntorit kryesisht nëpër shkollat e komunës, mirëpo aktivitete me program më të pasur kulturor artistik organizohen gjatë muajve korrik-gusht pasi që në këtë periudhë kthehen mërgimtarët në vendlindje dhe komuna është më e gjallëruar. Obligim i komunës është që t’ua bëjë qëndrimin më atraktiv banorëve që jetojnë jashtë vendit.

1.1.3.6. Turizmi

Pozita gjeografike e komunës së Bogovinës e bën mjaft të përshtatshme zhvillimin e turizmit rural dhe malor. Në këtë komunë gjendet liqeni i Bogovinës që është një nga 39 liqenet në Malin Sharr dhe si të tjerët nxisin turizmin rural. Ky liqen ndodhet midis Brustovec (Borislavec) dhe Mala Smreka në 1.936 m lartësi mbidetare, me një thellësi deri më 2.2 metra dhe ka një sipërfaqe prej 66,880 m¹⁸. Është e vendosur në një pellg shkëmbor, me një formë shumë të zgjatur, me një ndryshim të madh në gjerësi, kështu që ndryshon nga të gjitha liqenet tjera.

Përveç Liqenit të Bogovinës atraksion janë dy shtëpitë malore në Urviç të cilat kanë për qëllim paraqitjen komunës tonë si një destinacion të qëndrueshëm dhe të sigurt turistik, që do të përfshijë mikpritjen e turistëve vendas dhe të huaj. Gjithashtu, ky rajon është atraktiv për sporte ekstreme.

1.1.3.7. Sporti

Komuna e Bogovinës posedon dy salla sportive në Kamjan dhe Zherovjan. Komuna përkrah aktivitete sportive të të gjithë klubeve sportive që veprojnë në komunë.

¹⁷Ministria e shëndetësisë

¹⁸Komuna e Bogovinës

1.1.3.8. Karakteristikat ekonomike

Sipas të dhënave statistikore numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike aktive në vitin 2021 është 426 ¹⁹ në vitin 2020 kanë qenë të regjistruar 432 subjekte ekonomike ndërsa në vitin 2019 kanë qenë të regjistruar 422 subjekte ekonomike. Sipas këtyre të dhënave në vitin 2020 kemi një rritje të lehtë dhe në vitin 2021 përsëri ulje. Degët ekonomike në të cilët veprojnë subjektet ekonomike në territorin e komunës së Bogovinës janë tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, industria prodhuese, ndërtimtaria, transporti dhe magazinimi, aktivitetet e shërbimit të ushqimit etj.

Zejtaria

Zejtaria aktualisht ka një stagnim të caktuar në këtë zonë. Kjo situatë është si pasojë e faktorëve objektivë: investimet e pamjaftueshme, shndërrimi i objekteve zejtare në ndërmarrje me karakteristika të vogla të industrisë. Komuna nuk ka të dhëna më të detajuara sa i përket zejtarisë.

Shërbimet hotelierike

Shërbimet hotelierike në komunë kryhen kryesisht në objekte të vogla apo të mesme. Në komunë ka një numër të madh restorante dasmash, kafiteri, çajtore, pastiçeri dhe objekte të tjera më të vogla hotelierike.

Objektet e tilla janë të pranishme pothuajse në të gjitha vendbanimet, ku shumica e tyre punojnë në kushte moderne dhe me standarte europiane. Kapacitetet e objekteve të tilla ndryshojnë. Ambientet më të mëdha të hotelierisë kanë kapacitet për rreth 500 mysafirë, ndërsa ato më të voglat kanë mundësi të presin disa të ftuar.

Sipas të dhënave të regjistrimit të kapaciteteve hotelierike të entit statistikor²⁰ numri i objekteve hotelierike (restorante dasmash, kafiteri, çajtore, pastiçeri dhe objekte të tjera më të vogla hotelierike) është 132 me kapacitet prej 6443 ulëse që zënë një sipërfaqe prej 9262 m² dhe me gjithësej 238 të punësuar.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore në komunën e Bogovinës është 3.084 ha nga e cila 2.859 ha është e shfrytëzueshme, ndërsa 1.663,3 ha është nën ujë²¹.

Pjesa më e madhe e tokës bujqësore që përdoret gjegjësisht 89,5 %, është tokë e punueshme, kopshte dhe kopshte shtëpiake, ndërsa 9,8% janë livadhe dhe kullota, kurse zonat plotësisht të

¹⁹Enti shtetëror i statistikës

²⁰Enti shtetëror i statistikës

²¹Plani integruar për zhvillim lokal i komunës së Bogovinës 2019-2022

parëndësishme janë me pemishte dhe fidanishte. Hapësira e tokës bujqësore që përdoret sipas kategorive (në hektar) janë paraqitur në tabelën 3²².

Tabela 4. Toka bujqësore në komunën e Bogovinës

Gjithësej	Lulishte, kopshte dhe kopshte shtëpiake	Livadhe	Kullota	Pemishte	Vreshta	Fidanishte
2858,94	2557,47	221,11	57,68	18,61	2,97	1,11
100 %	89,5 %	7,7 %	2,0 %	0,7 %	0,1 %	0,0 %

Pjesa më e madhe e tokës së punueshme dhe kopshteve gjegjësisht 1.718,81 hektar shfrytëzohet për mbjelljen e drithërave. Kulturat drithërore më dominante janë misri, me një sipërfaqe prej 921,67 hektar (53,6%) dhe gruri me një sipërfaqe prej 761,48 hektar (44,3%). Për sipërfaqet e vogla me nën kultura industriale dominon rrepa e sheqerit me 77,5% nga sipërfaqja e përgjithshme, ndërsa tek kulturat furagjere me 492 hektar (90,1%) jonxha. Tek kulturat kopshtare vend të rëndësishëm zë patatja (73,42 hektar), specat (48,53 hektar), fasulja (36,81 hektar), lakra (24,31 hektar) etj.

Pronarët individual në komunën e Bogovinës disponojnë me 217,23 hektar pyje, prej të cilave mbi 95% janë pyje gjethërenëse të pastra ose të përziera, ndërsa vetëm një pjesë e vogël janë pyje me gjelbërim të përhershëm. Llojet më të zakonshme pyjore janë ahu dhe lisi.

1.1.3.9. Tregu i fuqisë punëtore

Sipas të dhënave të Agjencionit për punësim, numri i personave të papunë në vitin 2019 ka qenë 1.497 nga të cilët 36,6% janë persona të papunë më shumë se dy vite.

Në vitin 2020 numri i personave aktiv që kërkojnë punë të evidentura në Agjencionin për punësim janë 3.731, nga të cilët 1.240 janë femra. Nga kjo vërejmë se për një vit kemi një rritje të konsiderueshme të personave të papunë edhe atë për më shumë se 100%. Në këtë numër ka ndikuar situata me pandeminë e COVID 19, ku në atë kohë shumë biznese u mbyllën dhe shumë persona mbeten të papunë. Ndërsa, në vitin 2021 kemi një ulje të numrit të pesonave që në mënyrë aktive kërkojnë punë për afro 20%.

Në tabelat në vijim janë paraqitur evidencat e personave të papunë sipas grupmoshave të ndryshme ku me numër më të lartë janë personat nga 30 deri në 59 vjet. Numri më i lartë i personave të papunë janë pa arsim ose me arsim fillor.

²²Plani integruar për zhvillim lokal i komunës së Bogovinës 2019-2022

Tabela 5. Persona të papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim-Tetovë që në mënyrë aktive kërkojnë punë në vitin 2020

Komuna e Bogovinës	Gjithësej	Nga 15-29 vjet	Nga 30-44 vjet	Nga 45-59 vjet	Mbi 60 vjet
Gjithësej	3.731	1.045	1.228	1.204	254
Meshkuj	2.491	676	809	826	180
Femra	1.240	369	419	378	74

Burimi: Të dhëna nga Agjencionin për punësim

Tabela 6. Persona të papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim-Tetovë që në mënyrë aktive kërkojnë punë për vitin 2021

Komuna e Bogovinës	Gjithësej	Nga 15-29 vjet	Nga 30-44 vjet	Nga 45-59 vjet	Mbi 60 vjet
Gjithësej	2961	709	1024	987	241
Meshkuj	1.973	461	671	672	169
Femra	988	248	353	315	72

Burimi: Të dhëna nga Agjencionin për punësim

1.1.3.10. Mjedisi jetësor

Gjendja e mjedisit jetësor në komunë është relativisht e mirë. Nuk ka ndotës të mëdhenj, të cilat mund të degradojnë në shkallë të lartë resurset natyrore.

Komuna e Bogovinës, një pjesë e saj bën pjesë në Parkun kombëtar Mali Sharr. Me shpalljen e Malit Sharr park kombëtar edhe komuna e Bogovinës do të ketë përfitime të mëdha si në aspektin e menaxhimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore, ashtu edhe me projekte zhvillimore në fushën e turizmit malor.

Grumbullimi dhe bartja e mbeturinave

Situata e përgjithshme në këtë fushë nuk është në nivelin e duhur, duke pasur parasysh se ka ende një numër të madh të deponive ilegale dhe keq menaxhimi i vetë procesit nga institucionet përgjegjëse krijon mundësinë e krijimit të një sasive të madhe mbetjesh që më vonë paraqet problem për pastrim dhe shkaktojnë ndotje. Është rënë dakord që të gjitha komunat e rajonit të Pollogut të deponojnë mbeturinat në deponinë në Rusino, por kjo është një zgjidhje e përkohshme, problemet mbeten dhe kërkojnë gjetjen e një zgjidhjeje funksionale

të përhershme²³. Në komunën e Bogovinës grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave e kryen ndërmarrja komunale “Sharri”. Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2021 është 6240m³, ku të njëjtat transportohen deri në Rusino. Mbeturinat grumbullohen vetëm në 9 vendbanime nga gjithësej 16 vendbanime²⁴. Të dhëna më të detajuara në tabelën në vijim.

Tabela 7. Numri i shfrytëzuesve të shërbimeve komunale në ndërmarrje (grumbullimi i mbeturinave)

	Vendbanimet	Amvisëritë	Afaristët
1	Bogovinë	1.343	173
2	Pirok	1.001	78
3	Kamjan	1.069	103
4	Pallçisht	897	56
5	Sellarcë e Epërme	415	26
6	Kallnik	328	15
7	Siniçan	297	22
8	Zherovjan	264	23
9	Rakovec	144	4

Në vendbanimet që shtrihen në pjesën malore të komunës, për shkak të pozitës së tyre dhe infrastrukturës të papërshtatshme, nuk bëhet grumbullimi dhe bartja e mbeturinave nga amvisëritë dhe bizneset lokale. Për të përmirësuar gjendjen aktuale në Programin për zhvillim të rajonit planor të Pollogut janë definuar masat dhe aktivitetet që duhet të ndërmerren që të përmirësohet gjendja aktuale:

- Krijimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave;
- Përcaktimi, ndërtimi dhe menaxhimi i një deponie rajonale sipas standardeve të BE-së;
- Mbyllja e deponive të egra;
- Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave;
- Rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit publik përmes fushatave publike dhe bisedave me amvisëritë dhe industrinë;
- Përforcimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve publike etj.

²³ Programi për zhvillimin i rajonit planor të Pollogut 2021-2026

²⁴ Të dhëna nga ndërmarrja “Sharri” Komuna e Bogovinës

Parqet dhe gjelbërimet

Duke marrë parasysh se komuna e Bogovinës është komunë rurale, hapësira të gjelbërta ka mjaftueshëm mirëpo problemi është se nuk janë të rregulluara dhe të mirëmbajtura për qëllime rekreative.

1.2. Organizimi i vetëqeverisjes lokale Bogovinë

1.2.1. Komuna e Bogovinës

1.2.1.1. Kryetari

Në bazë të nenit 55 të Statutit të komunës së Bogovinës, Kryetari i komunës në kuadër të kompetencave të tij²⁵:

- inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e këshillit të Komunës;
- e siguron realizimin e punëve që i janë deleguar nga organi i drejtorisë shtetërore;
- e propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës;
- e realizon buxhetin e komunës;
- vendos në punët drejtuese për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave juridik dhe fizik në pajtim me Ligjin;
- udhëheq me administratën komunale;
- sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;
- vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale nëse në tjetër mënyrë nuk është përcaktuar me Ligj;
- zgjedh drejtorë të NP të themeluara nga komuna në bazë të konkursit publik;
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me Ligj dhe me Statut.

1.2.1.2. Këshilli i komunës

Këshilli i komunës së Bogovinës përbëhet nga 19 këshilltarë nga parti të ndryshme politike, të gjithë të etnitetit shqipëtar, prej të cilëve 13 janë meshkuj dhe 6 femra. Të partisë politike BDI janë 9 këshilltarë, të AA-5, BESA-4 dhe LSDM-1.

Në bazë të nenit 34 të Statutit të komunës dhe rregullores së Këshillit të komunës, Këshilli i kryen punët vijuese²⁶:

- sjell Statut të komunës;
- sjell Rregullore të Këshillit;
- sjell program pune;

²⁵ Komuna e Bogovinës

²⁶ <https://komunabogovine.gov.mk/wp-content/uploads/2022/09/Statuti.pdf>

- sjell buxhet të komunës dhe llogari vjetore të komunës;
- e përcakton lartësinë e tatimeve dhe lartësinë e kompensimeve dhe taksave;
- sjell plan gjeneral urbanistik;
- sjell plane detaje urbanistike dhe dokumentacion urbanistik për vendbanimet në Komunë;
- sjell program për rregullimin e tokës ndërtimore;
- sjell program për mirëmbajtjen e sinjalizimit të komunikacionit dhe dokumente tjera të përcaktuara me ligj dhe statut.

Për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e tij Këshilli formoi komisione. Komisionet e Këshillit formohen si të përhershme dhe të përkohshme.

- Komisionet e përhershme të Këshillit komunal janë:
- Komisioni për financim, buxhet dhe zhvillim lokal;
- Komisioni për urbanizëm, shërbime komunale, mbrojtje të ambientit jetësor;
- Komisioni për veprimtari shoqërore;
- Komisioni për Statut dhe dispozita;
- Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërrime;
- Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.
- Komisioni për vetadministrim të vendit dhe
- Komisioni për shënim të manifestimeve si dhe për ndarje të dhuratave dhe mirënjohjeve.


1.2.2. Organizimi i administratës

Në përputhje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, komuna drejtohet nga Kryetari dhe Këshilli Komunës, Këshilltarët janë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë, me mandat 4 (katër) vjeçar. Punët dhe detyrat në komunën e Bogovinës, si dhe llojet dhe numri i formave organizative përcaktohen dhe grupohen sipas natyrës së punëve dhe detyrave në kompetencën e përcaktuar me ligj.

Komuna është e organizuar në 3 sektorë: Sektori për çështje juridike dhe çështje të përgjithshme administrative (Njësia për çështje normative dhe ligjore, Njësia për çështje të përgjithshme administrative), Sektori për veprimtari publike (Njësia për arsim, kulturë, sport, mbrojtje shëndetësore dhe sociale, Njësia për zhvillim ekonomik lokal) dhe Sektori për çështje financiare (Njësia për koordinimin dhe kontroll buxhetor, Njësia për kontabilitet, pagesa dhe administrim i taksave dhe tatimeve) si dhe në 4 njësi të pavarura: Njësia për urbanizëm, mbrojtje të ambientit jetësor, shërbime komunale, komunikacion dhe rrugë, Njësia për mbikqyrje inspektoriale, Njësia për revizion të brendshëm dhe Njësia për menaxhim me burimet njerëzore.

Në komunën e Bogovinës me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët janë të hapura 3 Zyra vendi funksionale edhe atë në vendbanimet Bogovinë, Kamjan dhe Urviç.

Figura 1. Organogrami i komunës



1.2.3. Palët e interesuara - ndikimi, pritshmëritë dhe resurset

Palët e interesuara për zhvillimin ekonomik lokal të komunës së Bogovinës janë:

- **Udhëheqësia dhe administrata e komunës.**

Interesi buron nga nevoja për ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe subjektet afariste si dhe dëshira për shfrytëzim më të madh të potencialit ekonomik që është në dispozicion. Jo vetëm kaq, përmes kësaj Strategjie synohet jo vetëm që të shfrytëzohet potenciali ekzistues ekonomik, por edhe të krijohen mundësi të reja për potenciale të reja.

Ndikimi i udhëheqësisë komunale është përmes:

-Rregullimit i hapësirës dhe ndërtimi i infrastrukturës komunale;

-Përcaktimi i taksave, tarifave komunale dhe të dhënave tjera;

-Financimi i programeve për tërheqjen e investitorëve dhe krijimi i parakushteve me qëllim rritjen e aktiviteteve ekonomike në territorin e komunës;

-Krijimin e mundësive të reja investuese;

Burimet në dispozicion të komunës për financimin e zhvillimit janë: buxheti komunal, kapaciteti administrativ për menaxhim me projekte, si dhe burimet natyrore si psh. vendet turistike dhe vendet atraktive në territorin e Komunës.

Ajo çka pritet për atë që është investuar është rritje e qarkullimit të pasurive të paluajtshme (taksa e qarkullimit të pasurive të paluajtshme); rritja e përdorimit të hapësirës (pagesa për shërbimet komunale); rritja e investimeve dhe vendeve të reja të punës (TVSH dhe taksa personale); rritja e punësimit (taksa personale dhe kontributet); rritja e të hyrave dhe fondeve nga burimet e jashtme të financimit (buxheti i komunës).

- **Sektori privat**

Sektori privat ka interes për rritjen e volumit të punës dhe rentabilitetit përmes njohurive të organizimit të prodhimit, inovacionit dhe zhvillimit teknologjik, rritja e investimeve dhe përmirësimi i konkurrencës.

Burimet në dispozicion të tyre janë: produktet dhe shërbimet; tregjet; klientët dhe furnizuesit; stafi profesional dhe pajisjet teknologjike.

Pritshmëritë e sektorit privat nga zhvillimi ekonomik lokal janë aksesimi më i mirë dhe më i lirë në burime, informacion, tregje të reja, staf të kualifikuar dhe sistemin e prokurimit publik etj.

- **Organizatat joqeveritare**

Organizatat joqeveritare dhe shoqatat profesionale kanë rol kyç në përmirësimin e statusit dhe perspektivës së grupeve të synuara të qytetarëve që janë objekt i aktiviteteve të tyre.

Burimet në dispozicion të tyre janë: përvoja në projekte; kontakte dhe marrëdhënie të ngushta me qytetarët; kapacitet dhe njohuri për zbatimin e projekteve si dhe përvojë në tërheqjen dhe përdorimin e fondeve të ndryshme.

Nga zhvillimi ekonomik lokal kanë pritshmëri në kyçjen e tyre në vendimarrjen e komunës në çështjet që kanë të bëjnë për të mirën e banorëve, më shumë projekte dhe shfrytëzim maksimal të fondeve.

- **Banorët**

Të gjithë banorët duhet të jenë përkrahës dhe të japin ide për zhvillim që të kenë mirëqenie dhe standard të mirë jetësor.

- **Organet dhe institucionet shtetërore**

Qendra për zhvillimin e rajonit planor të Pollogut dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë janë të interesuara për rritjen e bazës së tatimpaguesve, aktiviteteve të tyre ekonomike, si dhe rritjen e mjeteve për programet e tyre.

- **Donatorët dhe programet e BE-së**

Kanë interes për rritjen e efekteve nga përdorimi i programeve të tyre, ndërtimin e institucioneve për menaxhimin e zhvillimit dhe ndikimin për një standard më të mirë të jetesës së banorëve.

1.3. Trendet e zhvillimit të komunës së Bogovinës 2019-2021

1.3.1. Lëvizja e popullsisë

1.3.1.1. Banorët

Në bazë të të dhënave statistikore, në 3 vitet e fundit lindshmëria më e lartë ka qenë në vitin 2020 me 272 edhe atë duke paraprirë meshkujt krahas femrave, ndërsa në vitin 2021 ka ulje të lindjeve²⁷.

Të dhëna më të detajuara të paraqitura në tabelën në vijim.

²⁷Enti shtetëror i statistikës

Tabela 8. Lindshmëria në periudhën 2019-2021

Bogovinë	Gjithësej lindje	Të lindur të gjallë	Gjinia	
			Meshkuj	Femra
2021	241	241	129	122
2020	272	272	155	117
2019	268	264	143	121

Ndërsa, në bazë të të dhënave vdekshmëria më e lartë ka qenë në vitin 2020, nga të cilët 160 meshkuj dhe 150 femra. Këto rezultate i referohen edhe situatës me pandeminë me COVID-19²⁸. Të dhëna më të detajuara në tabelën 9.

Tabela 9. Vdekshmëria në periudhën 2019-2021

Komuna e Bogovinës	Gjithësej vdekje	Gjinia	
		Meshkuj	Femra
2021	300	146	154
2020	310	160	150
2019	196	89	107

1.3.1.2. Fëmijët

1.3.1.3. Nxënësit dhe arsimi fillor

Në komunën e Bogovinës është i pranishëm vetëm arsimi fillor.

Ekzistojnë gjashtë shkolla fillore qendrore dhe tetë shkolla fillore territoriale. Numri i nxënësve në arsimin fillor nga viti 2019 deri në vitin 2021 ka pësuar ulje. Ndërsa, numri i mësimdhënësve në regjistrimet e vitit 2019/2020 ka qenë 341 nga të cilët 212 femra, pastaj në vitin 2020/2021 kemi ulje të këtij numri dhe në vitin 2021/2022 ngritje të numrit të mësimdhënësve nga të cilët 62% janë femra.

Në tabelat në vijim janë paraqitur numri i nxënësve dhe numri i mësimdhënësve në bazë të të dhënave statistikore për periudhën 2019-2021.

²⁸ Enti shtetëror i statistikës

Tabela 10. Numri i nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2019-2021

Viti	2019/2020	2020/2021	2021/2022
Gjithësej	2762	2678	2657
Nxënës	1 442	1 398	1 388
Nxënëse	1320	1280	1269

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

Tabela 11. Numri i mësimdhënësve në vitin shkollor 2019-2021

Mësimdhënës	2019/2020	2020/2021	2021/2022
Gjithësej	265	267	278
Mësimdhënës	106	96	99
Mësimdhënëse	159	171	179

Burimi: Enti shtetëror i statistikës

1.3.2. Trendet ekonomike

1.3.2.1. Subjektet ekonomike

Në Republikën e Maqedonisë numri i përgjithshëm i subjekteve ekonomike në bazë të sektorëve të veprimtarisë në vitin 2019 ka qenë 422, ku në vitin 2020 ky numër është zvogëluar në nivel shtetëror ndërsa në nivel komunal ka një rritje të lehtë ku janë regjistruar 432 subjekte.

Ndërsa në vitin 2021, ky numër është ulur si në nivel shtetëror ashtu edhe në atë komunal. Rritja më e madhe e numrit të subjekteve ekonomike është në sektorin e ndërtimitarisë, ndërsa sektorët tjerë kanë pësuar ulje. Të dhëna më të detajuara në tabelën 12.

Tabela 12. Numri i subjekteve aktive në bazë të sektorëve të veprimtarisë

Veprimtaritë	2019		2020		2021	
	Bogovinë	RMV	Bogovinë	RMV	Bogovinë	RMV
Gjithësej	422	75.914	432	73.061	426	72.992
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria	15	2.605	14	2.414	15	2.361
Minierat dhe gurëroret	-	221	-	201	-	198

Industria prodhuese	79	8.362	91	8.011	88	7.943
Furnizimi me energji elektrike, gas avull dhe ajër të kondicionuar	-	224	-	198	-	225
Furnizim me ujë, largimi i ujrave të zeza, menaxhium me mbeturina	4	260	4	248	4	252
Ndërtimtaria	58	5.270	66	5.263	71	5.386
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi automjeteve dhe motoçikletave	145	23.140	141	22.191	137	21.908
Transporti dhe magazinimi	21	5.780	19	5.625	16	5.531
Objektet e akomodimit dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	36	4.777	38	4.694	33	4.679
Informata dhe komunikim	2	2.041	1	2.069	3	2.199
Veprimtari financiare dhe veprimtari për sigurim	-	470	-	473	-	482
Veprimtari për patundshmëri	-	645	-	608	-	602
Veprimtari profesionale, shkencore dhe teknike	10	7.636	10	7.651	10	7.801
Veprimtari administrative dhe shërbime ndihmëse	4	1.962	3	1.856	3	1.901
Administratë publike dhe mbrojtje; sigurimi i detyrueshëm shëndetësor	1	264	1	260	1	262
Arsimi	6	1.222	6	1.277	6	1.272
Veprimtari për mbrojtje sociale dhe shëndetësore	21	3.357	20	3.304	20	3.307
Art, argëtim dhe rekreacion	5	1.404	4	1.655	4	1.612
Veprimtari tjera shërbyese	15	4.804	14	5.063	15	4.999

Sipas madhësisë së subjektit me numër më të madh janë mikro ndërrmarjet edhe atë me mbi 75%. Të dhëna më të detajuara në tabelën 13.

Tabela 13. Ndërrmarjet ekonomike sipas madhësisë

	2019	2020	2021
Mikro	325	321	321
Ndërrmarje të vogla	92	107	101
Ndërrmarje të mesme	5	4	4
Ndërrmarje të mëdhaja	0	0	0

1.3.3. Punët ndërtimore, objekte dhe banesa

Në rajonin e Pollogut në vitin 2019 janë ndërtuar 331 objekte, ndërsa vetëm në komunën e Bogovinës janë ndërtuar 57 objekte që është 17.22 % nga numri i përgjithëm i objekteve të ndërtuara në rajonin e Pollogut. Në vitin 2020 dhe në vitin 2021 ka rritje në ndërtimtari si në nivel rajonal ashtu edhe në nivel komunal, ku komuna e Bogovinës në vitin 2020 bën pjesë me 18.8% dhe në vitin 2021 me 13, 8%. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në tabelën 14.

Tabela 14. Punët e kryera ndërtimore, sipërfaqja dhe vlera e tyre 2019 -2021

	2019		2020		2021	
	Pollog	Bogovinë	Pollog	Bogovinë	Pollog	Bogovinë
Numri i objekteve	331	57	392	74	484	67
Vlera e punëve të kryera ndërtimore në 000 denarë	1.997.040	210.403	2.115.397	304.869	3.186.960	268.733
Numri banesave të kryera	426	50	465	69	645	55
Sipërfaqja e banesave të kryera në m ²	61.185	10.012	73.915	12.690	97.304	10.351

Tabela 15. Punët e kryera ndërtimore në bazë të llojeve të objektëve ndërtimore, në përputhshmëri me Nomenklaturën e punëve ndërtimore, në mijë (000) denarë në Komunën e Bogovinës 2019-2021

Në 000 denarë	2019	2020	2021
Gjithësej	311.673	316.506	438.535
Ndërtesa banimi	192.557	292.511	238.487
Ndërtesa jo banimi	40.549	16.138	70.475
Infrastruktura transportuese	3.936	-	-
Linjat e tubacioneve dhe linjat elektrike	20.790	638	123.207
Konstrukcionet komplekse industriale	-	-	-
Objektet tjera të ndërtimeve të ulta	-	-	3.457
Rikonstruim, sanim, adaptim riparime dhe mirëmbajtje të rregullt të objekteve	50.243	5.475	-
Punë ndërtimore	3.598	1.744	2.819

1.4. Pjesëmarrja e buxhetit komunal në financimin e zhvillimit

Buxheti i komunës analizohet sipas të hyrave dhe shpenzimeve, programeve të realizuara dhe shpenzimeve kapitale.

1.4.1. Të ardhurat dhe shpenzimet

Në periudhën 2019-2021 buxheti komunal është pothuajse në të njëjtin nivel, në vitin 2019 dhe 2021 është rreth 260,000,000 denarë, ndërsa në vitin 2020 ka qenë 271,762,717 denarë.

Në strukturën e të ardhurave buxhetore pjesëmarrje më të madhe kanë transferet dhe dotacionet dhe pasojnë të ardhurat tatimore. Në vitin 2019 shpenzimet e rrogave kanë qenë 151,452,564 dhe në vitin 2021 shpenzimet e rrogave dhe shtesave kanë qenë 175, 633,878. Të dhënat më të detajuara janë paraqitur në tabelën në ANEKS (**tabela 17. Të ardhurat buxhetore në Komunën e Bogovinës 2019-2021**).

Në periudhën e njëjtë 2019-2021 shpenzimet më të mëdha janë për rrogat dhe shtesat pastaj pasojnë mallrat dhe shërbimet. Të dhënat më të detajuara janë paraqitur në tabelën në ANEKS (**tabela 18. Shpenzimet e buxhetit të Komunës së Bogovinës 2019-2021**).

1.4.2. Të ardhurat dhe shpenzimet kapitale

Në periudhën kohore për të cilën është bërë analiza 2019-2021, komuna ka punuar me 13 programe, 135,145,211 denarë a pjesmarrje më të madhe ka Programa për ndërtim dhe rikonstruim të rrugëve 60, 520,133 denarë. Të dhëna më të detajuara në tabelën në ANEKS **(tabela 19 Shpenzimet në bazë të programeve të buxhetit komunal 2019-2021).**

Sa i përket investimeve kapitale për tre vitet në të cilët është bërë analiza 2019,2020 dhe 2021 janë shpenzuar 147,072,811.00 denarë për 32 projekte.

Tabela 16. Investimet kapitale në bazë të programeve zhvillimore 2019-2021

Programet zhvillimore/ investimet kapitale	2019		2020		2021		Gjithësej	
	Nr. i projekteve	Vlera në MKD	Nr. i projekteve	Vlera në MKD	Nr i projekteve	Vlera në MKD	Nr i projekteve	Vlera në MKD
Infrastrukturë moderne dhe mjedisi pastër	8	28,147,889.00	4	14,580,000.00	3	6.000,000,00	15	48,727,889.00
Modernizimi i rrjetit për ujësjellësin dhe kanalizimin			3	35,306,735.00			3	35,306,735.00
Arsim kualitativ	2	3,300,000.00	4	7,155,578.00	2	2.280,830,00	8	12,736,408.00
Zhvillim rural dhe bujqësi								
Kultura dhe sporti	1	33,273,817.00					1	33,273,817.00
Kulturë e pasur								
Rinia, sporti dhe rekreacioni	1	2,500,000.00					1	2,500,000.00
Turizmi atraktiv, tradicional dhe modern	1							
Mbrojtja sociale	2	13,312,962.00			1	1.215,000,00	3	14,541,274.00
Gjithësej	15	80,534,668.00	11	57,042,313.00	6	9,495,830.00	32	147,072,811.00

Në bazë të analizës së bërë, konkludojmë se në vitin 2020 për shkak të pandemisë me COVID 19 kemi një rënie të lehtë të të ardhurave tatimore, ndërsa në vitin 2021 kemi rritje të ndjeshme.

Rritja e vazhdueshme e shpenzimeve për rroga duhet të ndalohet me qëllim që këto mjete të alokohen për programe të ndryshme zhvillimore me qëllim të nxitjes së aktiviteteve ekonomike, investimeve, hapja e vendeve të reja të punës që të rriten të ardhurat buxhetore.

Rritja e shpenzimeve kapitale në totalin e shpenzimeve mund të jetë një nxitje për investimet totale në komunë, ringjalljen e aktivitetit ekonomik dhe ruajtjen e vendeve ekzistuese të punës.

1.5. Qëndrimet e palëve të interesuara në drejtimin e zhvillimit lokal

1.5.1. Anketa e aktorëve relevant në zhvillimin lokal

Me qëllim të krijimit të bazës solide për zhvillimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Bogovinës, janë realizuar 14 intervista me palë të ndryshme të interesit dhe persona kyç të informuar, përfaqësues të pushtetit lokal (administrata komunale, ndërmarrjet publike dhe këshilli komunal).

Subjektet ose pjesëmarrësit e këtyre intervistave u identifikuan dhe u përfshinë duke marrë parasysh profilin dhe fushat e tyre të veprimtarisë, në mënyrë që të lejohet që sa më shumë grupe të synuara ose përfaqësues nga sektorë dhe nivele të ndryshme të përfshihen dhe të kenë mundësinë të japin vlerësimet e tyre dhe ide për çështje në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

1.5.1.1. Mendimi i anëtarëve të këshillit

Si rezultat i intervistave të realizuara rezulton se këshilltarët e intervistuar deri diku kanë informacione për planet apo programet aktuale të punës si dhe projektet që realizohen brenda komunës dhe duhet 'u jepet prioritet realizimit të programeve dhe projekteve që janë prioritare për përmirësimin e jetës së banorëve.

Ata kanë cilësuar se fushat në të cilët duhet të merren masa dhe të jenë prioritet në komunë janë infrastruktura, uji për pije, kualiteti i ujit të pijshëm, eficientia e energjisë, ruajtja e mjedisit jetësor dhe menaxhimi me mbeturinat, higjiena, deponitë, riciklimi, zhvillimi ekonomik lokal (turizmi, tregtia, bujqësia, zhvillim rural), rinia dhe sporti, zhvillimet e telekomunikacionit, zhvillimi i arsimit kualitativ, mbrojtja sociale e fëmijëve dhe barazia gjinore.

Ndër fushat më me prioritet sipas këshilltarëve që duhen intervenim janë eficientia energjetike, mbrojtja sociale dhe barazia gjinore, zhvillimi ekonomik, mjedisi jetësor, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbeturinat.

Në lidhje me pyetjen për masat dhe projektet më prioritare që pushteti lokal duhet të ndërmarrë për zhvillimin ekonomik lokal janë:

Projekte infrastrukturore që përfshinë studime fizibiliteti për ujin e pijshëm si dhe inspektime të punëve infrastrukturore.

Mbrojtja sociale e fëmijëve- investime në metoda bashkëkohore për zhvillim të fëmijëve, modernizim të klasave nëpër shkolla si dhe ndërgjegjësim për bullizmin.

Investime për sport dhe rekreacion, funksionimi i sallave të sportit, pishina të mbyllura dhe përkrahje të klubeve sportive.

Projekte për menaxhimin e mjedisit, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, mbeturinat dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e ambientit.

Sa i përket pyetjes për digjitalizimin e shërbimeve komunale dhe ofrimin e shërbimeve këshilltarët potencojnë se banorëve u nevojiten mjete të TIK-ut (Teknologjia e informacionit dhe komunikimit) të dobishme për përmirësimin e proceseve të punës dhe ofrimin e shërbimeve komunale, siç janë shërbime nga urbanizmi, pagesa (online) e detyrimeve publike lokale, tatimeve komunale, dokumenteve administrative (kërkesa, konfirmime, vendime) dhe shërbime të tjera.

Në lidhje me pyetjen për bashkëpunimmes autoriteve lokale, sektorit privat dhe sektorit civil, cilësohet si bashkëpunim i mirë, por në të ardhmen ky bashkëpunim të thellohet me qëllim të përmirësimit të shërbimeve komunale, llogaridhënies dhe transparencës për të mirën e banorëve.

1.5.1.2. Mendimi i administratës komunale

Anketa me anëtarët e administratës komunale përfshin intervista me përfaqësues dhe udhëheqës nga sektorët kryesorë si: sektori për financa, sektori i urbanizmit, sektori për veprimtari publike (njësia për ZHEL, njësia për arsim, kulturë dhe sport), udhëheqës i njësisë për çështje juridiko-normative, përgjegjës për arsim, përfaqësues të njësisë për burime njerëzore dhe njësisë për revizion të brendshëm.

Sa i përket mendimeve dhe rekomandimeve të të punësuarve të administratës, ata janë shprehur se punët kryejnë në bazë të planeve dhe programeve të përcaktuara.

Ata kanë cilësuar se për problemet e banorëve të komunës së Bogovinës që janë nën juridiksionin e sektorit të tyre ndërmarrin masa në drejtim të rradhitjes dhe respektimit të prioriteteve të tyre dhe në zbatimin e transparencës. Gjithashtu e kanë cilësuar se më se të nevojshme janë projektet për barazi gjinore, përmirësimi i procesit edukativo arsimor duke u kthyer të gjithë palët relevante, hapja e qendrave për përkujdesje për fëmijët me nevoja të veçanta si dhe projekte tjera në fushën e mbrojtjes sociale, ulja e papunësisë, ndërtimi i rrugëve lokale, ndërtimi dhe sanimi i rrugëve për zhvillim të bujqësisë, ndërtimi i kanaleve për ujitjen e tokës pjellore, ndërtimin e infrastrukturës rrugore deri te bjeshkët e Sharrit, me qëllim të

zhvillimit të blegtorisë, përpilimi i dokumentacionit/ azhurimi i tyre dhe finalizimi i projekteve për kanalizim në vendbanimet e komunës.

Në lidhje me pyetjen për bashkëpunimin me institucionet tjera të anketuarit në administratën komunale potencojnë se kanë bashkëpunim të rregullt dhe aktiv me një numër të madh institucionesh nga pushteti qendror dhe lokal, organizata ndërkombëtare dhe ambasada dhe zyra përfaqësuese të huaja, që kanë të bëjnë me çështjet dhe fushat në të cilat veprojnë.

Në lidhje me pyetjen për problemet që hasin administrata komunale gjatë zbatimit të punës së tyre, kanë të bëjnë më shumë me përpilimin e planeve për komunikim më të mirë me të gjitha organet shtetërore, përpilime profesionale të dokumentacionëve teknike si dhe probleme të çështjeve pronësore - juridike.

Në lidhje me pyetjen për formën e komunikimit me palët e interesuara dhe qytetarët në procesin e identifikimit të problemeve dhe zgjidhjeve të mundshme të tyre përfshihen takime të ndryshme, fokus grupe, forume, komunikime nëpërmjet bashkësive lokale, shqyrtim të kërkesave në këshillin komunal, nëpërmjet rrjeteve sociale si dhe tabelave informative.

Në lidhje me monitorimin dhe raportimin e punëve të anketuarit e sektorëve dhe administratës komunale raportojnë rregullisht me shkrim dhe me gojë një herë në javë, një herë në muaj si dhe përmes raporteve tremujore, ndërsa sipas nevojës apo kërkesës së palëve të interesuara raportimi mund të jetë edhe më shpeshtë.

II

2. Qasja strategjike

2.1. Analiza e mjedisit

2.1.1. Analiza PESTLE

Analiza **PESTLE** është një mjet analitik i përdorur për të identifikuar nxitësit kryesorë të ndryshimit në mjedisin strategjik dhe për të mbështetur vendimmarrjen strategjike. PESTLE përfshin faktorë politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ekologjikë dhe juridikë.

Faktorët karakteristikë që ndikojnë në zhvillimin e komunës së Bogovinës janë:

2.1.1.1 Faktorët politikë

Decentralizimi - Zbatimi i planit akcional për monitorimin të decentralizimit dhe fuqizimi i kapaciteteve të komunave për realizimin e kompetencave ligjore.

Statusi "Pozicional" me Qeverinë - Bashkëpunimi me Qeverinë, ministrinë dhe agjencionet shtetërore, institucionet përcaktojnë pozitën e vetëqeverisjes lokale sa i përket qasjes në programet rajonale dhe kombëtare.

Eurointegrimet - Republika e Maqedonisë së Veriut si vend kandidat për anëtarësim në BE është duke ndërmarrë hapa konkret të cilat do të reflektohen edhe në komunat që do të duhet të ndërmarrin një pjesë të detyrimeve për të arritur qëllimin e synuar.

Siguria dhe stabiliteti i vendit/rajonit - Për dy dekada rajoni i Evropës, veçanërisht Ballkani, u prek nga turbulenca të mëdha dhe destabilitet. Kjo situatë ende nuk është tejkaluar, por anëtarësimi i RSM-së në NATO jep garantimin e sigurisë dhe stabilitetit të shtetit. Fillimi i bisedimeve me BE-në është një sinjal se zhvillimi do të marrë kahjen e duhur.

2.1.1.2. Faktorët ekonomikë

Investimet e huaja direkte - Politika e Qeverisë për të tërhequr investimet e huaja direkte do të ndikojnë edhe në investime në komunë.

Stabiliteti i politikës makroekonomike - Norma e inflacionit, stabiliteti i kursit të denarit, situata me pandeminë e COVID-19, kriza energjetike dhe shumë faktorë të tjerë kanë ndikim të madh në biznes klimën, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Kapacitete administrative për tërheqjen e fondeve të ndryshme nga fondet europiane dhe organizatat ndërkombëtare.

2.1.1.3. Faktorët socio-kulturor

Besimi në Qeveri - Udhëheqja komunale duhet të udhëheqë një politikë të punës profesionale dhe të jetë më aktive dhe transparente në shërbimet që ofron, si dhe me përfshirjen sa më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimarrjes në komunë.

Niveli i ulët i vetëdijes për mjedisin e qytetarëve - Shqetësimi i qytetarëve për shëndetin dhe mjedisin e pastër është në nivel shumë të ulët. Futja e një edukimi më të mirë dhe më aktiv (duke filluar që nga bankat shkollore) dhe vendosja e vazhdueshme e sanksioneve ndaj qytetarëve dhe sektorit të biznesit si ndotës më të mëdhenj mund të japin rezultate të kënaqshme.

Migrimet rurale-urbane dhe emigracioni jashtë vendit. Vitet e fundit emigrimi drejt vendeve të Bashkimit Europian është mjaft i theksuar si në nivel shtetëror ashtu edhe në nivel komunal. Kjo dukuri në rradhë të parë zvogëlon potencialin për zhvillimin e zonave rurale duke shkaktuar mungesë të fuqisë punëtore.

2.1.1.4. Faktorët teknologjik

E-Qeveria është “titulli i miratuar” i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të qeverisë dhe agjencive publike dhe po transformon mënyrën se si institucionet komunikojnë me qytetarët. Përdorimi i tij premtan rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të institucioneve dhe ndryshon rrënjësisht qëndrimin e tyre ndaj publikut.

Digjitalizimi është një trend botëror që futet në të gjitha sferat e jetesës dhe punës. Përmirësimi i aftësive të punonjësve është çelësi për të vazhduar me ndryshimet e imponuara nga digjitalizimi.

2.1.1.5. Faktorët e mbrojtjes së mjedisit jetësor

Efiçienca e energjisë – Çështjet e kursimit të energjisë dhe shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë janë gjithnjë e më shumë objekt i punës së komunave. Kriza energjetike globale e vitit 2022 akoma më shumë i ka nxitur komunat të ndërmarrin masa për efikasitetin energjetik edhe atë duke ndaluar ndriçimin publik për disa orë apo ndryshimi i tërë sistemit të ndriçimit publik me qëllim kursimi.

Ekonomia e gjelbër dhe mbrojtja e mjedisit kanë efektet më të mëdha në nivel lokal -Sipas kornizës ligjore në fushën e mjedisit jetësor njësitë e vetqeverisjes lokale kanë një sërë kompetencash për ruajtjen e mjedisit jetësor veçanarisht në menaxhimin me mbeturina.

2.1.2. SWOT Analiza e njësive të vetëqeverisjes lokale

Analiza SWOT përdoret për të vlerësuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet, të përfshirë në zhvillimin ekonomik lokal. Analiza përfshin përcaktimin e qëllimit të zhvillimit dhe identifikon faktorë të brendshëm ose të jashtëm, të favorshëm ose të pafavorshëm, për të arritur qëllimin.

Analiza SWOT përfshin urbanizmin, infrastrukturën, ekonominë, bujqësinë dhe zhvillimin rural, zhvillimin e turizmit, integrimin evropian dhe përdorimi i fondeve të BE-së, burimet njerëzore dhe mbrojtjen e mjedisit.

	Ndikimi pozitiv	Ndikimi negativ
S W O T	<p>Strengths - Përparësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Pozita e volitshme gjeografike, shtrirja territoriale në rrëzë të Parkut kombëtar "Mali Sharr", -Afërsia me komunat urbane dhe kryeqytetin, -Ekzistimi i sipërfaqeve bujqësore, -Ekonomia-ekzistimi i mikro dhe ndërrmarjeve të vogla, -Fuqi punëtore të disiplinuar, -Potencial eksportues në sajë të lidhjeve të ngushta me diasporën 	<p>Weaknesses - Dobësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Mungesa e planeve urbanistike, -Obstrukcionet dhe burokracia institucioneve qendrore, -Mungesa e mjeteve/fondeve të jashtme për zhvillim, -Mungesa e infrastrukturës elementare turistike, -Mungesa e koordinimit mes sektorëve dhe institucioneve, -Mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme për zhvillim të komunës, -Papunësia, -Mungesa e ekspertizës në sfera të caktuara me interes ekonomik për komunën
	<p>Opportunities - Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Për zhvillim të bujqësisë përmes përmirësimit të teknologjisë dhe granteve të ndryshme në bujqësi, -Për zhvillim të turizmit rural përmes granteve të ndryshme, -Stimulim i sektorit privat për investime në hapjen e vendeve të reja të punës, -Efikasiteti energjetik dhe ekonomia e gjelbërt, -Thithje më efikase e fondeve të Bashkimit European, -Vendosje e bashkëpunimit më intensiv mes ndërrmarjeve lokale dhe afaristëve me njohuri teknologjike "know-how" në diasporë 	<p>Threats - Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndikimi i krizave botërore/COVID 19/Inflacioni/Shtrejtimi i energjisë elektrike/Paraqitja e pandemive të ndryshme, -Rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe nivelet e larta të inflacionit, -Migrimi i kuadrove të kualifikuara, -Migrimi i rinisë, -Kriza politike dhe zgjedhjet e shpeshta qendrore -Konkurrenca jo lojale

2.2. Qëllimet strategjike të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Bogovinës

2.2.1. Vizioni i komunës

Komuna e Bogovinës deri në vitin 2027 do të jetë komunë lider në rajon, me zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë, përmirësimi i prodhimit bujqësor dhe standardi/cilësia e lartë e jetës një mjedis të mbrojtur dhe të pastër, me një infrastrukturë të planifikuar dhe cilësore në përputhje me nevojat e qytetarëve, me zhvillim të siguar të vazhdueshëm të fuqisë punëtore.

2.2.2. Misioni i komunës

Komuna e Bogovinës ka për mision që të jetë më tërheqëse me mundësi investimi për zhvillim të mëtejshëm të përsheptuar të ekonomisë dhe bujqësisë, me mjedis të pastër me planifikim hapësinor dhe me efikasitet të energjisë dhe me infrastrukturë të zhvilluar, me administratë profesionale që punon sipas standardeve më të larta për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët nëpërmjet menaxhimit efikas dhe efektiv të burimeve në dispozicion.

2.2.3. Qëllimet strategjike

Implementimi i Strategjisë për zhvillim lokal të Komunës së Bogovinës për periudhën 2023-2027 përfshinë realizimin e 3 qëllimeve strategjike, të cilat përbëhen prej më shumë aktiviteteve në fushat e veprimit:

QËLLIMI STRATEGJIK 1	Përmirësimi pozitës socio-ekonomike të banorëve
QËLLIMI STRATEGJIK 2	Përforcimi i konkurrencës së ekonomisë lokale dhe zhvillimi rural përmes tërheqjes së biznesve dhe investitorëve të rinj
QËLLIMI STRATEGJIK 3	Mbrojtja e mjedisit jetësor, menaxhimi i qëndrueshëm resurseve natyrore natyrore dhe efikasiteti e energjisë

2.2.4. Ndjekja e realizimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

Ndjekja e realizimit të Strategjisë do të kryhet si në nivel të realizimit të aktiviteteve dhe rezultateve të planifikuara ashtu edhe në nivel të suksesit të Strategjisë në drejtim të arritjes së qëllimeve strategjike.

Në nivel strategjik, vetëqeverisja lokale do të bëjë një vlerësim periodik të zbatimit të strategjisë pas kalimit të 3 viteve nga miratimi i saj. Rekomandimet nga vlerësimi i dhënë periodik do të përdoren sipas nevojës për rishikimin e Strategjisë. Para përfundimit të vitit të

katërt nga zbatimi i Strategjisë, vetëqeverisja lokale do të bëjë një vlerësim përfundimtar sipas treguesve të përcaktuar dhe vlerave përfundimtare të tyre dhe gjetjet do të përdoren si pikënisje për hartimin e Strategjisë së ardhshme për zhvillim ekonomik lokal.

Suksesi i Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal do të vlerësohet sipas kritereve të mëposhtme:

- **Rëndësia:** A korrespondojnë objektivat dhe rezultatet e Strategjisë me nevojat dhe prioritetet e përcaktuara të zhvillimit ekonomik lokal?
- **Efektiviteti:** Shkalla në të cilën janë arritur qëllimet, domethënë, a kanë dhënë masat dhe aktivitetet rezultatet e pritura? A mund të ishte arritur më shumë?
- **Efikasiteti:** A janë përdorur të gjitha burimet në dispozicion në zbatimin e Strategjisë? A u arritën qëllimet dhe rezultatet me burimet më të pakta të mundshme?
- **Qëndrueshmëria:** A janë masat dhe aktivitetet e zbatuara në kuadër të Strategjisë të qëndrueshme dhe a do të kenë efekte pozitive në zhvillimin ekonomik lokal të komunës edhe pas përfundimit të periudhës së Strategjisë 2023-2027?

III

1. Plani akcional

QËLLIMI STRATEGJIK 1: Përmirësimi i pozitës socio-ekonomike të banorëve						
Nr.	Prioritetet	Aktivitetet	Indikatorët	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Vlera
1.1	<i>Përmirësimi i infrastrukturës komunale</i>	<p>Ndërtimi i rrugëve dhe urave të reja;</p> <p>Rikonstrumi i urave dhe rrugëve ekzistuese</p> <p>Përmirësimi i sinjalizimit në komunikacion për këmbësorët dhe automjetet;</p> <p>Ndërtimi i trotuareve për këmbësorë dhe çiklist;</p> <p>Ndërtimi i rrjetit për furnizim me ujë në disa vendbanime;</p> <p>Riparimi i rrjetit ekzistues të ujit;</p> <p>Vendosja e orëmatësve me qëllim të moskeqpërdorimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit për pije;</p> <p>Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimit atmosferik;</p> <p>Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimit</p>	<p>Aplikimi me projekte dhe implementimi</p> <p>Përgatitja e dokumentacionit teknik të përshtatshëm për zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore ekzistuese</p> <p>Ndërtimi i sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza</p> <p>Rritja e sigurisë rrugore dhe trafikut në përgjithësi</p> <p>Sistemet e reja dhe të rinovuara të furnizimit me ujë</p> <p>Numri i amvisërive që janë të përfshira në sistemin publik të</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p><i>Qendra</i> për zhvillim të rajonit planor të <i>Pollogut</i>;</p> <p>Ministria e vetëqeverisjes lokale;</p> <p>Ministria e financave;</p> <p>Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor;</p> <p>Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural;</p> <p>Byroja për zhvillim rajonal;</p> <p>Ministria e transportit dhe lidhjeve;</p> <p>Organizatata e</p>	391.000.000 MKD

		<p>fekal;</p> <p>Përpilimi i planeve gjenerale urbanistike në të gjitha vendbanimet;</p> <p>Përpilimi planeve detale urbanistike në të gjitha vendbanimet;</p>	kullimit dhe të furnizimit me ujë		ndryshme joqeveritare;	
1.2	<i>Përmirësimi i shërbimeve komunale</i>	<p>Riorganizimi i administratës</p> <p>Trajnime adekuate për administratën komunale për thirrjet vendore dhe ndërkombëtare;</p> <p>Rrjetëzimi me komunat tjera të rajonit dhe më gjërë</p> <p>Vënia në funksion sistemit me një sportel në komunë</p> <p>Organizimi i takimeve me qytetarët</p> <p>Transparenca</p>	<p>Numri trajnimeve të organizuara</p> <p>Numri i nëpunësve shtetëror të trajnuar</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës,</p> <p>Organizata joqeveritare;</p> <p>Kompani që ofrojnë shërbime konsultative;</p>	10.000.000 MKD
1.3	<i>Përmirësimi i kualitetit të procesit edukativo-arsimor</i>	<p>Rikonstruimi dhe riparimi i objekteve shkollore</p> <p>Furnizimi i shkollave me pajisje speciale për orët praktike</p> <p>Involvimi i nxënësve në projekte të ndryshme ndërkufitare dhe europiane</p> <p>Ndërtimi i bibliotekës</p>	<p>Objektet e rinovuara dhe të ndërtuara;</p> <p>Numri i pajisjeve për kabinetet e shkollave;</p> <p>Aplikimi me projekte dhe implementimi;</p> <p>Numri i nxënësve të trajnuar</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p>Ministria e arsimit dhe shkencës;</p> <p>Shkollat fillore dhe çerdhja;</p> <p>Byroja për arsim-Tetovë</p> <p>Donatorë të mundshëm;</p>	120.000.000 MKD

					Erasmus+	
1.4	Përmirësimi i jetës sociale duke përfshirë grupet e marginalizuara (fëmijët, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, gratë etj.)	<p>Ndërtimi dhe rekonstruimi i parqeve për fëmijë</p> <p>Rritja e kapaciteteve në çerdhe</p> <p>Hapja e qendrave ditore inkluzive për fëmijë</p> <p>Rritja e bashkëpunimit me OJQ-të për aplikim në projektet për përmirësimin e shërbimeve sociale</p> <p>Njoftimi i grave dhe kyçja e tyre në projekte të ndryshme për barazi gjinore;</p> <p>Kampanja të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për barazi gjinore;</p> <p>Kampanja për ngritjen e vetëdijes për personat me nevoja të veçanta dhe ndihmë për hulumtim të tregut të punës;</p> <p>Projekte të ndryshme për ndihmë dhe përkujdesje për personat e moshuar</p>	<p>Parqet e ndërtuara;</p> <p>Aplikimi me projekte dhe implementimi</p> <p>Info-ditët e organizuara</p> <p>Numri i kampanjave të organizuara;</p> <p>Numri i grave pjesëmarrëse në kampanja;</p> <p>Numri i institucioneve të sapo formuara për mbrojtje sociale</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p>Ministria e punës dhe politikës sociale;</p> <p>Agjencia për punësim;</p> <p>Donatorë;</p> <p>Kompanitë që ofrojnë shërbime konsultative;</p>	109.000.000 MKD
1.5	Përmirësimi i jetës rinore përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore	<p>Ndërtimi i Shtëpisë së kulturës në komunë</p> <p>Mbështetja e SHKA-ve ekzistuese në komunë dhe talenteve të rinj</p>	<p>Numri i anëtarëve të rinj të SHKA-ve</p> <p>Zhvillimi i programeve të reja kulturore</p> <p>Numri i objekteve</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p>Agjencia për rini dhe sport;</p> <p>Ministria e kulturës;</p> <p>Organizatrat</p>	300.000.000 MKD

		Organizimi i rregullt i manifestimeve kulturore dhe sportive	sportive të rinovuara Numri i objekteve të reja sportive Numri i talentëve të rinj sportiv të mbështetur		joqeveritre; Shoqëritë kulturore artistike;	
--	--	--	--	--	--	--

QËLLIMI STRATEGJIK 2: Përforcimi i konkurrencës së ekonomisë lokale dhe zhvillimi rural përmes tërheqjes së biznesve dhe investitorëve të rinj

Nr	Prioritetet	Aktivitetet	Indikatorët për realizim	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Vlera
2.1	<i>Përmirësimi i klimës së biznesit në nivel komunal</i>	<p>Vënia në funksion e këshillit lokal ekonomik ;</p> <p>Organizimi i ditëve informative për informimin e përfaqësuesve të interesuar të ndërmarrjeve me përfaqësues të institucioneve shtetërore për mundësitë për qasje dhe kreditim;</p> <p>Organizimi i sesioneve informative mbi mundësnë e kthimit të investimeve nga projektete investuese;</p> <p>Informimi dhe mbështetja e ndërmarrësve për fondet IPARD;</p> <p>Rritja e atraktivitetit, prodhimtarisë përmes zgjidhjeve moderne, inovative tekniko- teknologjike;</p> <p>Mbështetja e grave sipërmarrëse për zhvillimi të bizneseve ekzistuese ose gjatëhapjes së bizneseve të reja;</p> <p>Mbështetja e iniciativave private</p>	<p>Numri i teknologjive të reja të miratuara;</p> <p>Numri dhe lloji i seminareve, edukimi i sipërmarrësve dhe numri i sipërmarrësve që kanë qenë të përfshirë në programat;</p> <p>Numri i hapjes së vendeve të reja të punës;</p> <p>Numri i studimeve të bëra;</p> <p>Numri i programeve nacionale që përdoren;</p> <p>Databaza e formuar për biznes sektorin</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p><i>Qendra për zhvillim të rajonit planor të Pollogut;</i></p> <p>Regjistri qendror;</p> <p>Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural</p>	6.000.000 MKD

		<p>për ndërtim të kapaciteteve të reja, adaptimi i atyre ekzistuese dhe prokurimi i paisjeve dhe maqinerive;</p> <p>Nxitje e zhvillimit të turizmit rural dhe krijimi i produkteve të brenduara;</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe sinjalizimit;</p> <p>Zhvillimi i atraksioneve turistike, shërbimeve dhe kapaciteteve;</p> <p>Zhvillimi dhe rregullimi i zonave turistike;</p> <p>Përmirësimi i bashkëpunimit kulturor ndërkufitar dhe ndërkombëtar përmes projekteve IPA- CBC;</p> <p>Krijimi i një databaze për ndërmarrjet në komunën e Bogovinës</p>				
2.2	<i>Nxitja e zhvillimit të bujqësisë dhe rritja e produktivitetit</i>	<p>Formimi i qendrës komunale për mbështetje të bujqëve individual;</p> <p>Organizimi i ditëve informative për risitë në bujqësi;</p> <p>Organizimi i ditëve informative për</p>	<p>Numri i projekteve të aplikuara dhe të miratuara nga fondet e UE;</p> <p>Numri i ditëve informative të organizuara;</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p><i>Qendra për zhvillim të rajonit planor të Pollogut;</i></p>	24.000.000 MKD

	<p>mundësitë në qasje deri tek fondet për bujqësi dhe blegtori;</p> <p>Krijimi i sektorit bujqësor modern dhe produktiv ;</p> <p>Mbështetja e inicijatiave të reja për zhvillimit të bujqësisë;</p> <p>Mbështetja në inovacionet në bujqësi;</p> <p>Ndërtimin i infrastrukturës që dërgojnë deri tek tokat bujqësore;</p> <p>Krijimin e sistemeve për ujitje të tokave bujqësore</p>	<p>Numri i personave që marrin pjesë në ditët informative;</p> <p>Infrastruktura e përmirësuar dhe ndërtuar</p>		<p><i>Ministria e bujqësisë;</i></p> <p>Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural;</p> <p>Shtëpitë që ofrojnë shërbime konsultative</p>	
--	--	---	--	--	--

QËLLIMI STRATEGJIK 3: Mbrojtja e mjedisit jetësor, menaxhimi i qëndrueshëm resurseve natyrore natyrore dhe efienca energjetike

Nr.	Prioritetet	Aktivitetet	Indikatorët	Korniza kohore	Institucionet përgjegjëse	Vlera
3.1	<i>Ruajtja e mjedisit jetësor dhe menaxhim i qëndrueshëm me resurset natyrore</i>	<p>Përforcimi dhe modernizimi i maqinerisë së NPK-së Sharri;</p> <p>Prokurimi i automjeteve, maqinerive dhe paisjeve të reja për nevojat e NPK-së;</p> <p>Përforcimi e kapaciteteve të të punësuarve në NPK;</p> <p>Koordinimi me institucione dhe partnerë tjerë për deponimin në një deponi me standarde;</p> <p>Vendosja e bashkëpunimit rajonal në fushën e menaxhimit me mbeturinat inerte;</p> <p>Sanimi, rregullimi dhe mbyllja e deponive të egra;</p> <p>Përgatitja e studimeve për mbrojtjen e mjedisit;</p> <p>Organizimi i kampanjave për ngritjen e vetëdijes për ruajtjen e mjedisit jetësor;</p>	<p>Aplikimi me projekte dhe implementi;</p> <p>Numri deponive të pastruara;</p> <p>Numri i automjeteve dhe pajisjeve tjera të fituara;</p> <p>Kampanjat e organizuara për ngritjen e vetëdijes;</p> <p>Numri i të punësuarve të trajnuar</p>	2023-2027	<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p>Ndërmarrja Publike Komunale “Sharri”;</p> <p>Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor;</p> <p><i>Qendra për zhvillim të rajonit planor të Pollogut;</i></p> <p>Shtëpitë që ofrojnë shërbime konsultative</p>	9.000.000 MKD

3.2	<p><i>Nxitja e shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe zbatimi i efikasitetit energjetik (EE)</i></p>	<p>Edukimi, promovimi dhe kampanja për ndryshimet klimatike dhe ngritja e vetëdijes për zbatimin e EE;</p> <p>Rritja e efikasitetit energjetik në objektet publike;</p> <p>Mbështetja e banorëve në zbatimin e masave për EE;</p> <p>Rritja e efikasitetit energjetik në ndriçimin publik</p>	<p>Aplikimi me projekte dhe implementimi;</p> <p>Kosto më të ulët të energjisë në objektet publike;</p> <p>Kosto më të ulët e ndriçimit publik;</p> <p>Kampanjat e mbajtur për ngritjen e vetëdijes</p>		<p>Komuna e Bogovinës;</p> <p>Ministria e ekonomisë;</p> <p>Ministria e financave;</p> <p>Kompanitë që ofrojnë shërbime konsultative</p>	<p>70.000.000 MKD</p>
-----	--	---	---	--	--	-----------------------

ANEKS

Tabela 17. Të ardhurat buxhetore në komunën e Bogovinës 2019-2021

Përshkrimi	2019		2020		2021	
	Të realizuara	Pjesëmarrja në %	Të realizuara	Pjesëmarrja në %	Të realizuara	Pjesëmarrja në %
Gjithësej	255,023,266	67%	271,762,717	71%	255,637,284	77%
Të ardhurat tatimore	36,009,563	68%	29,375,318	55%	41,829,189	76%
Tatimi mbi të ardhurat	1,171,936	10%	1,395,208	108%	1,445,436	76%
Tatimi në pronë	16,438,101	82%	10,664,636	50%	17,336,541	77%
Taksa për shërbime specifike	18,399,526	54%	17,315,474	56%	23,034,912	75%
Taksat	0				12,300	100%
Të ardhurat jo tatimore	1,805,235	42%	1,403,825	32%	2,784,720	54%
Gjoha dhe tarifa administrative	544,956	71%	398,094	76%	544,860	94%
Taksat dhe kompensimet	537,375	53%	291,170	36%	329,750	65%
Shërbimet tjera qeveritare	30,000		27,000	90%		0%
Të ardhura tjera jotatimore	692,904	28%	687,561	23%	1,910,110	47%
Të ardhurat kapitale	2,530,075	11%	1,334,340	9%	272,712	2%
Shitja e aseteve kapitale	0		0			
Shitje toke dhe investime jomateriale	2,530,075	11%	1,334,340	9%	272,712	2%
Transferet dhe	214,678,393	84%	228,740,279	80%	204,689,911	85%

dotacionet						
Nivelet e tjera të qeverisjes	214,433,993	83%	227,789,007	85%	202,304,936	88%
Donacione të huaja	244,400	1%	951,272	5%	2,384,975	19%
Huamarrje			10,908,955	44%	6,060,752	44%

Tabela 18. Shpenzimet e buxhetit të komunës së Bogovinës 2019-2021

	2019		2020		2021	
Shpenzimet/ gjithësej	254,941,863	67%	270,068,520	70%	254,752,925	77%
Rroga dhe shtesa	151,452,564	96%	170,414,944	98%	175,633,878	98%
Rezerva	647,500	43%	237,000	12%	330,000	17%
Mallra dhe shërbime	42,520,487	55%	32,343,718	49%	33,783,237	57%
Interesi			8,123	32%	32,566	33%
Subvencione dhe transferta	4,625,580	47%	5,075,808	48%	5,704,737	67%
Përfitime sociale	0		0		0	
Shpenzime kapitale	55,695,732	41%	61,988,927	47%	39,268,507	49%
Shlyerje						
Deficit						

Tabela 19. Shpenzimet në bazë të programeve të buxhetit komunal 2019 - 2021

Shpenzimet	Të realizuara 2019	Pjesëmarrja në %	Të realizuara 2020	Pjesëmarrja në %	Të realizuara 2021	Pjesëmarrja në %
Gjithësej	254,941,863	67%	270,068,520	70%	254,752,925	77%
Këshilli i komunës	5,457,021	66%	7,191,178	69%	6,926,624	73%
A3 detyrime të pashlyera	9,839,467	100%				
A1 Aktivitete zgjedhore					1,500,000	100%
Kryetari	3,256,873	60%	2,566,645	43%	2,818,228	69%
Administrata komunale	28,336,623	75%	27,902,234	82%	30,973,545	90%
Harxhimet kapitale të komunës	668,581	9%	2,307,522	25%	5,400,670	67%
Gjithësej komuna	47,558,565	62%	39,967,579	55%	47,619,067	80%
Programe						
Planifikimi urban						
Rregullimi i tokës ndërtimore						
Rregullimi i tokës ndërtimore-shpenzimet kapitale						
Mbështetja e zhvillimit ekonomik lokal						
Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës			1,415,905	40%		
Projekte për efikasitetin energjetik						
Rregullimi dhe pastrimi i ujërave të zeza					2,907,936	30%
Ndriçimi publik	10,930,294	94%	9,423,322	85%	8,419,410	97%
Ndërtimi i ndriçimit publik	575,690	64%	654,046	87%	1,565,451	50%
Pastërtia publike-sh.kapitale	124,667	25%	10,908,955	44%	6,060,752	44%
Mirëmbajtja e rrugëve	753,975	35%			496,076	31%
Ndërtimi dhe rekonstruimi i	21,394,739	36%	21,131,260	49%	17,994,134	53%

rrugëve						
Mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave të gjelbërta	1,094,313	53%	679,788	96%		
Parqe dhe gjelbërime-shpenzime kapitale			833,100	93%		
Shpenzime kapitale në kulturë	24,998,241	42%	21,481,719	69%	115,566	96%
Barazia gjinore						
Ndërtimi i sistemeve për ujësjellësit	516,036	24%	617,836	10%	3,392,848	57%
Ndërtimi i sistemit për mbeturina						
Deponi për mbeturina						
Transporti publik-shpenzimet kapitale						
Manifestimet kulturore dhe krijimtaria						
Sporti dhe rekreacioni	1,130,000	90%	495,000	77%	530,000	93%
Sporti dhe rekreacioni - shpenzimet kapitale						
Bashkëpunimet ndërkombëtare					169,333	50%
Zhvillimi i resurseve njerëzore						
Transferet						
Arsimi fillor	145,602,519	98%	159,385,206	99%	164,399,213	100%
Arsimi shpenzimet kapitale			3,055,623	99%	86,606	11%
Çerdhet e fëmijëve			19,181	15%	814,734	20%
Çerdhet e fëmijëve-shp.kapitale					63,720	16%
Ndërtimi i sinjalizimit në komunikacion	262,824	88%			118,079	20%
Mbrojtja sociale-shpenzimet kapitale						